

Sa do të mund të kurseni në muaj?

Harxhimet familjare	
Celular	
Udhëtime	
Rryma elektrike	
Nxemja/ujj	
Veshmbathja	
Ushqimi	
Nevojat e fëmijëve	
Dasmat	
Blerja kur çmimet janë të larta	
Blerja e gjërave shtesë	
Festa të shtrenjta dhe dhurata	
Shprehi të këqija	
Të tjera	
SHUMA totale e kursyer në muaj	



**Mbani mend: vendosni çmime reale!**  
**Mundoheni të harxhoni sa më pak që është e mundshme, por kurseni atëherë kur me të vërtetë mundeni t'ia lejoni vetes atë, pa vënë në rrezik veten dhe familjen tuaj.**

**Në fund: mos mërziteni se nuk do të mund t'ia lejoni vetes të gjitha kënaqësitë! Vetëm duhet të jeni të sigurt se mund të menaxhoni me harxhimet dhe se ato janë të arsyeshme - dhe zvogëloni harxhimet e panevojshme.**

Lehtë është të kursehet! Lejoni të tjerët t'ju tregojnë se si:



• **Arta:** "Kur do më kthejnë kusurin në dyqan, do i kursejë paratë e vogla. Ata në fund me të vërtetë mblidhen shumë."



• **Albrim:** "Fillova të shfrytëzojë transportin publik, në këtë mënyrë kursej derivate për veturën time."



• **Mimoza:** "Kur e marr pagën, në fillim ndaj 5 %, e mandej pjesën tjetër e ndaj për ushqim, fatura, etj."



• **Rezarta:** "Tështa për dimër blej në pranverë, kurse për verë në vjeshtë - kur ka zbritje të mëdha!"



• **Kaltrina:** "Dua të blej kompjuter të ri kur ka zbritje, prandaj kursej nga pak çdo javë, dhe i lë anash."

## ME KURSIM TË DENARËVE, DERI TE REALIZIMI I ËNDËRRAVE!

### Zgjedhja e mënyrës së duhur të kursimit

Kursimi i parave në bankë? Nëqoftëse është ashtu, atëherë duhet të njoftoheni me karakteristikat kryesore të shërbimeve të kursimit dhe shërbimeve devizore ose produkteve të bankës.

Paratë që ruhen në bankë quhen "depozitë". Depozitat dallohen në bazë të maturimit, qëllimit, vlerës minimale të deponimit dhe kushteve për tërheqjen e parave të deponuara. Bankat ju paguajnë interes sepse ju i ruani paratë tuaja tek ato.



Projekt për edukim financiar

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë  
bul. „Kuzman Josifovski Pitu“ nr.1,  
1000 Shkup  
www.nbzm.mk



Banka Popullore e  
Republikës së Maqedonisë

## Depozitat me afat kundrejt depozitave pa afat: cili është dallimi?

**Depozita me afat** nënkupton se pajtoheni që paratë tuaja ti ruani në bankë për kohë të caktuar dhe mos ti tërhiqni para afatit të maturimit.

**Depozita pa afat** nënkupton se mund ti tërhiqni paratë tuaja në çdo kohë. Keni kujdes: **shkalla e interesit tek depozitat pa afat në përgjithësi është shumë më e ulët se shkalla e interesit tek depozitat me afat.** Nga ana tjetër, për tërheqjen e parakohshme të depozitave me afat, vlejné **rregulla më rigorozë** (për shembull do e humbni interesin që do ta fitonit nëqoftëse nuk do e kishit tërhequr depozitën para kohe).

### Mbani mend:

**DEPOZITA ME AFAT - AFAT FIKS**  
**DEPOZITA PA AFAT - AFAT FLEKSIBIL**



Dua të kursej para për pushimet në korrik.

Depononi mjetet tuaja si depozitë me afat fikse deri në korrik - sepse e dini se nuk do ti harxhoni për punë tjera dhe në këtë mënyrë do të fitoni interesin e duhur.



Dua të kursej mjete për "nevoja të paparashikueshme". Për shembull, nëqoftëse vetura ime prishet, dua ti kem paratë e mija dhe jo të marrë kredi.



Depononi paratë tuaja si depozitë pa afat, gjegjësisht me afat fleksibil, dhe tërhiqni ato kur të keni nevojë, por do të fitoni shumë më pakë interes.



Ata janë paratë e juaja! Keni të drejtë që punonjësve të bankës tu parashtroni sa pyetje të doni. Mësoni se si banka do menaxhojë me paratë tuaja dhe cilat janë kushtet.

**Mbani mend: Sa më shumë që kurseni, aq më shumë do fitoni nga interesi. Sa më gjatë që kurseni, aq më të larta do të jenë të ardhurat tuaja nga interesi.**

**Paratë tuaja mund ti depononi si depozita në denar dhe depozita në deviza, për të cilat vlejné shkallë të ndryshme interesi, varësisht nga valuta që kursehet.**



Mos harroni se në vendin tonë depozitat tuaja (në denar dhe deviza, certifikatat për depozitë, të hollat në xhiro llogaritë transakcionale, depozitat e lidhura me kartelat pagesore dhe të hyrat devizore të personave fizik) janë të garantuara nga Fondi për sigurim të depozitave, i cili siguron depozitat e personave fizik. Nëpërmjet sigurimit të depozitave në banka, filialet e bankave të huaja dhe kursimoret, Fondi kontribuon në stabilitetin dhe besimin e publikut në sistemin bankar dhe financiar të vendit. Nëqoftëse banka dështon, Fondi do të dëmshpërblejë depozitat e siguruar, por në shumë jo më shumë se 30.000 euro në kundërvlerë të denarit për depozitë në bankë, filiale të bankës së huaj dhe kursimore.



Kursim? Sa e mërzitshme! Përveç asaj, ne s'kemi pse të kursejmë. Buxheti jonë familjar është i vogël dhe harxhojmë vetëm për atë që kemi nevojë."

Kursimi nuk do të thotë vënie e kufijve - por disiplinë. Ajo do të thotë që gjatë gjithë kohës të mendojmë atë që blejmë dhe të biem vendime të mençura se si ti harxhojmë paratë tona."



### Pse duhet të kursejmë?

Kursimi do të thotë ndarja e mjeteve anash, që të mund ti përdorim më vonë. Nëqoftëse e kurseni atë që do të ju ngelet pasi të keni mbuluar të gjitha nevojat e juaja ditore, me kalimin e kohës do të mund të keni para për realizimin e qëllimeve më të mëdha.

Kursimi ka të bëjë me paratë, por edhe me disiplinën dhe gatishmërinë. Çdokush mund të kursejë, madje edhe familjet me të ardhura të vogla.

Si për çdo shprehje tjetër, në fillim duhet kohë që ajo të fitohet dhe zhvillohet, mirëpo ju tanimë e keni atë që ju duhet për të qenë të suksesshëm.

Kursimi i parave SOT, do të thotë që në të ARDHMEN do të mund:

- ti realizoni qëllimet financiare të familjes tuaj (për shembull, ti paguani harxhimet e shkollimit, të blini veturë, të rinovoni shtëpinë tuaj, etj.);
- të menaxhoni me situata të papritura të jashtëzakonshme;
- ti mbuloni zbrazëtirat atëherë kur me të ardhurat tuaja s'do të mund të mbulonit nevojat tuaja elementare;
- të bëni investim të madh për shtëpinë apo biznesin tuaj.

## A jeni të gatshëm të filloni? Ja se si:



### – Definoni qartë qëllimin tuaj.

Pyetni veten: Për çka ju nevojiten paratë? Sa ju nevojiten dhe kur?

Vendimi: "duam të blejmë frigorifer" është tepër i përgjithshëm.

Nëse jeni dakord se "deri në fillim të vitit të ardhshëm duam të blejmë frigorifer që kushton rreth 15.000 denar" është mënyrë e shkëlqyer që të vendoset një qëllim.

### – Pyetni veten se për çka nuk duhet të harxhoni para.

Të gjithë ndonjëherë blejmë gjëra të panevojshme - mësoni ti gjeni dhe ta kontrolloni ato. Pse, për shembull, kur shkoni për të blerë, nuk i blini vetëm gjërat që keni në listë? A mund të blini "jashtë sezone" kur gjërat janë më lirë?

### – Ruani parat në vende që nuk keni shumë qasje.

Nëse nuk keni qasje të lehtë deri te paratë tuaja, ka mundësi që mos i harxhoni ato kur të paraqiten "sfida" të caktuara.

### – Kurseni "pak dhe shpesh".

Çdoherë kur do realizoni të ardhura, mundoheni të ndani një shumë të vogël kursimi (për shembull 10%)

Filloni sot dhe mundoheni që të mbeteni konsekuent.

**Mbani mend:** me kalimin e kohës, shumat e vogla do të bëhen kursime të mëdha!

## Kurseni ashtu që të harxhoni më pak



A e keni ditur se mund të kurseni duke harxhuar më pak në nevojat e përditshme? Për shembull, flisni më pak në celular, ose ti ç'kyçni dritat kur nuk janë të nevojshme. Rezultatit do ta shihni në fund!

A mund ti përcaktoni harxhimet e panevojshme të familjes tuaj?

Pyetni veten: sa në të vërtetë harxhoni, dhe sa realisht do mund të kurseni?

Shihni në tabelën e mëposhtme për ta kuptuar!